



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:026208

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624055

KPPP.nr. 148/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Inspektorati Shëndetësor”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit IPSH “Vatan Med” me pronar U.O., me seli në Prishtinë, rruga “Vëllezërit Fazliu”, nr. 329A, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 545/23 të datës 26.12.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit IPSH “Vatan Med”, me pronar U.O. i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 545/23 të datës 26.12.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Shala.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr. 545/23 të datës 26.12.2023 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 545/23 të datës 26.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr. 10/NY-32-22 të datës 22.03.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 4,000.00€ (katër mijë euro) dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me tarifat në fuqi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e përmbaruesit, regjistrimin,

sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e tyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se kreditori i ka caktuar gjobë në vlerë prej 8,000.00€ debitorit ndërsa debitori ka përmbushur pagesën e gjobës brenda 15 ditëve në shumë prej 4,000.00€, prandaj duke u bazuar në nenin 30, par. 3 të Ligjit 05/L-087 për Kundërvajtje i cili përcakton se *“3. Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar”*, debitori ka përmbushur obligimin detyrues ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të ndërpritet procedura përmbarimore, të anulohet propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori dhe të detyrohet debitori të bëjë pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje ndaj prapësimin të debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPPsë i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit Shëndetësor Nr. 10/NY-32-22 të datës 22.03.2022, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr. 10/NY-32-22 të datës 22.03.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti

përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr. 10/NY-32-22 të datës 22.03.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi Nr. 10/NY-32-22 të datës 22.03.2022, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor, është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 14.11.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka përmbushur detyrimin sipas pagesës prej 4,000.00€ të datës 04.04.2022 pasi që duke u bazuar në nenin 30, par. 3 të Ligjit 05/L-087 për Kundërvajtje i cili përcakton se *“3. Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar”*, mirëpo gjykata vlerësoi se në këtë rast në titullin përmbarimor nuk është përcaktuar kjo mundësi dhe të njëjtat pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore duke qenë se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.148/24, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.